



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1287/2022

Datë: 31 / 10 /2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të datës 21 tetor 2022, KPK/Nr. 1266 /2022, shpall:

SHPALLJE E BRENDASHME

- I. Për plotësim me tri (3) pozita për prokuror në Prokurorinë e Apelit.
- II. Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:
 1. Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
 2. Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë si prokuror, nga të cilat tri (3) vjet përvojë si prokuror në Departamentin e Specializuar të Prokurorisë Themelore ose në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
 3. Të ketë vlerësim të mjaftueshëm ose më të lartë të performancës;
 4. Vlerësimi "I mjaftueshëm" sipas Rregullores Nr. 12/2015 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit është pengesë për avancim, deri në vlerësimin e prokurorit sipas Rregullores Nr. 05/2020 për Vlerësimin e Performancës të Prokurorëve të Shtetit;
 5. Të mos ketë masa disiplinore në pesë (5) vjetët e fundit, përjashtimisht qortimit dhe vërejtjes jopublike;
 6. Të mos ketë filluar hetimi penal;
 7. Të ketë reputacion të lartë profesional;
 8. Me rastin e avancimit do të merren parasysh pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me njohuritë e përgjithshme në procedurë penale, mjetet juridike, praktika juridike e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja akademike, punimet shkencore, ligjërimi në akademi apo në nivel

universitar, angazhimi i prokurorit në sistemin prokurorial dhe pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

III. Kandidati që aplikon për avancim duhet të plotësojë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit¹ si dhe ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:

1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese të përbashkëta.

IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.

V. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 01 nëntor 2022 deri më datë 15 nëntor 2022.

VI. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e katërt (4) ndërtesa e Prokurorit të Shtetit, rruga "Luan Haradinaj" - Prishtinë, zyra numër 406, të mbyllura në zarf, ose me postë.

¹ Prokurorët të cilët aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://www.prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.